

**V E N D I M**  
**Nr.10, datë 31.7.1995**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

|                  |         |                        |
|------------------|---------|------------------------|
| Rustem Gjata,    | Kryetar | i Gjykatës Kushtetuese |
| Hilmi Dakli,     | Anëtar  | i “““                  |
| Manol Konomi,    | Anëtar  | i “““                  |
| Veli Budo,       | Anëtar  | i “““                  |
| Franc Jakova,    | Anëtar  | i “““                  |
| Alfred Karamuço, | Anëtar  | i “““                  |
| Zija Vuci,       | Anëtar  | i “““                  |
| Metush Saraçi,   | Anëtar  | i “““                  |

me sekretare Drita Filto, më datat 17.7.1995 dhe 31.7.1995, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr. 12 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S A: 1. SINDIKATA E PAVARUR E USHQIMIT E ALBTURIZMIT “ROZAFÄ, SHKODËR, e përfaqësuar nga kryetari Arif Murati dhe avokat Artan Gjylbegu me prokurë.

2. SHYQYRI, HASIM, HASAN, HYSEN, ADLIJE, HATIJE, RIFAT, HALIL, SHERIFE, ELEZ,MIMOZA, SUZANA, VJOLLCA, BUJAR, ALIDA, ZAIME, DITITA, ERJETA DHE ERVIN LAÇEJ, trashëgimtarë të ish-pronarëve të truallit mbi të cilin është ngritur Hotel Turizmi “Rozafa” Shkodër, të përfaqësuar nga Hasan LaçeJ dhe avokat Sokol Shazi, me prokurë të posaçme.

**O B J E K T I:**

Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.275, datë 5.6.1995 “Për formën e privatizimit të disa objekteve pronë shtetërore”, vetëm në pjesën ku është vendosur privatizimi të Hotel Turizmit “Rozafa” Shkodër.

1. Sindikata e Pavarur e Ushqimit (Dega e Albturizmit) “Rozafa”, ka parashtruar këto shkaqe :  
- Vendimi i mësipërm i Këshillit të Ministrave ka lejuar privatizimin pa ankand të Hotel Turizmit “Rozafa”, duke cënuar

në këtë mënyrë nenin 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 si dhe vendimet e Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993 dhe nr.195, datë 16.4.1993;

2. Trashëgimtarët e ish-pronarëve të truallit, kanë parashtruar këto shkaqe :  
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.275, datë 5.6.1995, vjen në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, sepse iu ka mohuar atyre të drejtën e parablerjes së këtij objekti pronë shtetërore.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

**V Ë R E N:**

Shkaqet e parashtruara nga Sindikata e Pavarur e Ushqimit (Dega Albturizmit) Shkodër, për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.275, datë 5.6.1995, janë të pabazuara në ligj.

Ajo duke vepruar si përfaqësuese e kolektivit punonjës të Hotel “Rozafa” Shkodër, ka pretenduar se me këtë vendim janë cënuar padrejtësisht interesat e këtyre punonjësve për shkak se këta janë mënjeluar nga e drejta e pjesëmarrjes në ankand që sipas saj është mënyra e vetme e privatizimit të këtij objekti pronë shtetërore. Këtë pretendim të saj e ka mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993 “Për disa masa për shpejtimin e privatizimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme”, por ajo nuk ka pasur parasysh se ky akt është shfuqizuar në mënyrë të shprehur nga vetë Këshilli i Ministrave me vendimin nr.203, datë 3.5.1995.

Jo vetëm kaq, por ky pretendim i saj nuk është i drejtë edhe për një arsye tjetër :

Nga përmbajtja e neneve 22 e 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, del

se ankandi nuk është forma e vetme e kalimit të pronës shtetërore në pronë private. Përkundrazi, këto dispozita parashikojnë edhe mënyra të tjera të privatizimit të kësaj prone, për të cilat është e autorizuar Agjencia Kombëtare e Privatizimit, pranë Këshillit të Ministrave.

Kërkesa e ish-pronarëve të truallit, për shpalljen antiligjor të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.275, datë 5.6.1995, në lidhje me privatizimin e Hotel “Rozafës” Shkodër në favor të të përndjekurve politikë, është e mbështetur tërësisht në ligj.

Ligji nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, i njeh të drejtën Këshillit të Ministrave të marrë masa favorizuese ndaj të përndjekurve politikë, por jo t’u njohë të drejtën e parablerjes së objekteve të ndërtuara mbi truallin e ish-pronarëve.

Përveç kësaj, ky Vendim vjen në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 21 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, ku thuhet shprehimisht : “Në trojet e zëna me ndërtime shtetërore, si dyqane, magazina, punishte, etj., ish-pronari ka të drejtën e parablerjes së këtyre objekteve, kur privatizohen me çmimet e përcaktuara sipas dispozitave në fuqi”.

Në këto rrethana, Këshilli i Ministrave mund të vendoste kalimin e objektit në favor të ish të përndjekurve politikë, vetëm në rast se trualli mbi të cilin është ngritur objekti nuk ka pronar, dhe kur pronari nuk e ushtron të drejtën e parablerjes që i njeh ligji.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24, pika 3 dhe 25 paragrafi i fundit të ligjit nr.7561, datë 29.4.1991 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

#### V E N D O S I:

Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.275, datë 5.6.1995, vetëm përsa i përket Hotel Turizmit “Rozafa” në Shkodër.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e shpalljes, datë 31.7.1995.

Kundër këtij vendimi votoi Rustem Gjata.

#### MENDIMI I PAKICËS

Nuk jam dakord me vendimin e dhënë nga shumica për këto arsye:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.275, datë 5.6.1995 “Për formën e privatizimit të disa objekteve shtetërore” me të cilin, ndër të tjera, është vendosur t’u ofrohet për blerje Hotel Turizmi “Rozafa” në Shkodër ish të burgosurve dhe të përndjekurve politikë, nuk është akt normativ. Si akt individual, ai ka karakterin e një akti administrativ që autorizon vetëm lidhjen e kontratës së shitjes midis subjekteve të përcaktuara në vetë vendimin dhe në listat e bashkangjitura.

Aktet administrative, pavarësisht nga subjektet që i nxjerrin ato, nuk mund të kundërshtohen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese. Sidomos me miratimin e ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, gjykata e zakonshme janë të autorizuar të shqyrtojnë kundërshtimet e qytetarëve dhe subjekteve të tjera lidhur me bazueshmërinë e akteve administrative.

Kështu, sipas nenit 14, të ligjit kushtetues të mësipërm, kushdo e ka të drejtën e rehabilitimit dhe zhdëmtimit, edhe në rast se është cënuar nga një akt administrativ i paligjshëm. Ndërsa në nenet 38 dhe 39 të këtij ligji, për cilindo është garantuar rivendosja e të drejtave në gjykatë.

Është e vërtetë se Gjykata Kushtetuese shqyrton edhe ankesat e personave për shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga çdo akt i paligjshëm. Por, sipas pikës 9 të nenit 25 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, Gjykata Kushtetuese zgjidh përfundimisht ankesat e personave, të paraqitura në rrugën e kontrollit kushtetues për shkeljen e të drejtave të tyre themelore.

Pra, shqyrtimi në këtë Gjykatë i ankesave të tilla mund të bëhet vetëm pasi të jetë konsumuar rruga e zakonshme gjyqësore. Pas shqyrtimit nga gjykatat, kur të drejtat kushtetuese të cënuara kanë

mbetur pa u zgjidhur, ankesa mund të paraqitet në Gjykatën Kushtetuese.

Një argument tjetër që vërteton se kundërshtimet e akteve administrative duhet të shqyrtohen në gjykatat e zakonshme, është edhe vetë përmbajtja e nenit 8, paragrafi i dytë të po këtij ligji. Sipas kësaj dispozite, gjykata e rrethit e pezullon gjykimin dhe ia dërgon materialet e çështjes Gjykatës Kushtetuese, vetëm kur arrin në përfundimin se akti normativ nuk pajtohet me ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe me ligjet.

Me përcaktimin e shkakut të pezullimit vetëm kur gjykatat ndodhen para një akti normativ, ligjvënësi nuk përfshin aktet e tjera jonormative. Prej kësaj del se gjykatat i shqyrtojnë vetë aktet e tjera që nuk kanë karakter normativ.

Gjykata Kushtetuese, duke e shqyrtuar drejtpërdrejt bazueshmërinë e Vendimit të Këshillit të Ministrave, legalizon faktin se gjykatat e zakonshme nuk janë kompetente të shqyrtojnë ankesat kundër akteve administrative, përveç atyre që janë parashikuar shprehimisht në këtë ligj.

Me këtë qëndrim, Gjykata Kushtetuese merr prerogativat edhe të një gjykate administrative.

Si përfundim, mendoj se çështja është në kompetencën e gjykatës së rrethit. Vetëm pasi të shqyrtohet nga të gjitha instancat gjyqësore, mund të paraqitet kërkesa në këtë gjykatë.

**K R Y E T A R I**  
**Rustem Gjata**

Tiranë, më 31.7.1995